

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist I (informacion), Sektori i Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (Kategoria III-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Vendimit Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2022”; Urdhër Nr.6667/1, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist I (informacion) ka për detyrë si më poshtë:

- Specialisti I i Sektorit të Burimeve Njerëzore varet direkt nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore.
- Mbulon veprimtarinë administrative për funksionimin optimal të ofrimit të shërbimit ndaj publikut në lidhje me kërkesa për takime, ankesa.
- Pret dhe informon qytetarët.
- Rregjistron ankesat e qytetarëve.

- Identifikon shqetësimet e qytetarëve dhe bashkërendon punën me strukturat e tjera administrative në institucion, për sqarimin dhe zgjidhjen e tyre.
- Rezervon takime të qytetarëve me Drejtorët e institucionit dhe me Kryeinspektorin e IMT.
- Vepron në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.
- Koordinon përgjigjen zyrtarë ndaj kërkesave për informacion ose ankesave të depozituara pranë IMT.
- Evidenton në vazhdimësi ankesat dhe problemet e bëra prezente nga të gjithë subjektet e interesuara dhe ndjek zbatimin e procedurave administrative përkatëse për sqarimin dhe dhënien e përgjigjes për çdo kërkesë.

Dokumentat që aplikanti për Specialist I (informacion) në Sektorin e Burimeve Njerëzore duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 07.07.2022 ora 16.30